

SHPALLJE PËR PRANIM TË DREJTPËRDREJTË NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES (TND)

Në zbatim të neneve 27 dhe 29, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të krerëve III dhe V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 38, datë 11.01.2026, të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2026”, Departamenti i Administratës Publike shpall procedurën e pranimi të drejtpërdrejtë në TND.

Numri i pozicioneve të TND për të cilat do të konkurrohet është 11.

Afati për dorëzimin e dokumentave: 25 Shkurt 2026

Përshkrimi përgjithësues i punës

Përgjegjës për:

- formulimin e politikave dhe këshillimin e tyre;
- përcaktimin e objektivave dhe formulimin e programeve, standardeve dhe procedurave përkatëse për zbatim;
- sigurimin e përdorimit eficient të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arritjen e objektivave;
- planifikimin dhe drejtimin e veprimtarisë së përditshme administrative të institucionit dhe përfaqësimin e tij në takime dhe forume brenda dhe jashtë vendit.

I.- Kanë të drejtë të konkurrojnë për këto pozicione:

1. **Nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese**, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:
 - a.- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të mesëm drejtues ose të barazvlefshme me to (një nga klasat e pagave që i përkasin kategorisë II);
 - b. - Të mos kenë masë disiplinore në fuqi, që nuk janë shuar sipas legjislacionit përkatës.

2. **Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura**, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:
 - a.- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të lartë drejtues në institucione të pavarura (një nga klasat e pagave që i përkasin kategorisë I).
 - b.- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të lartë drejtues në njësitë e vetëqeverisjes vendore (një nga klasat e pagave që i përkasin kategorisë I).
 - c.- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi, që nuk janë shuar sipas legjislacionit përkatës.

3. **Kandidatët nga jashtë shërbimit civil**, të cilët duhet të plotësojnë kriteret minimale si vijon:
 - a.- Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;
 - b.- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike”, ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
 - c.- Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlershme në:
 - institucione të administratës publike;
 - institucione bankare të nivelit të dytë e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
 - shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
 - organizata jofitimprurëse, të cilat kanë të paktën 5 (pesë) vjet që janë krijuar.

Përjashtimisht, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë:

- i. në institucione ndërkombëtare brenda vendit;*
- ii. në profesion jashtë vendit;*

iii. pedagogë në institucione të arsimit të lartë;

iv. avokatë, noterë apo kontabilistë, të miratuar brenda ose jashtë vendit;

kriteri i përvojës në punë të jetë të paktën 5 (pesë) vjet në këto institucione ose në profesion.

- ç.- Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative, të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.
- d.- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi, që nuk janë shuar sipas legjislacionit përkatës.

II.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Të gjitha grupet e kandidatëve si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- a.- Jetëshkrimin;
- b.- Fotokopje të diplomës;
- c.- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- ç.- Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimi brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
- d.- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- dh.- Dokumentacionin që provon që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, përveç sa më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

- a.- Fotokopje të letërnjoftimit (ID-së);
- b.- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- c.- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- ç.- Vërtetimin nga institucionet bankare të nivelit të dytë apo shoqëritë tregtare të cilat sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen si biznes i madh, në të cilat keni eksperiencë pune, që nuk kanë aktualisht detyrime ndaj shtetit, ose nuk janë në proces kundër tij.
- d.- Vetëdeklarim që nuk janë anëtarë të partive politike.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi deri në datën **25 Shkurt 2026**, në Departamentin e Administratës Publike.

Bulevardi "Zogu i I", Nr. 15, Tiranë.

III.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak.

Në datën **6 Mars 2026**, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë në faqen e tij të internetit www.dap.gov.al, në ambientet e tij dhe në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për të vijuar më tej.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail, për shkaqet dhe arsyet e moskualifikimit.

IV.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi.

Kandidatët pjesëmarrës në procedurë, pas verifikimit paraprak nga ana e njësise përgjegjëse, do të vlerësohen për:

A. Njohuritë mbi:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
- Kompetencat e institucioneve të ndryshme dhe vendi që zenë ato në strukturën e përgjithshme qeveritare;
- Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës publike (ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”);
- Programin e qeverisë;
- Prioritetet e qeverisë;
- Detyrimet e Shqipërisë për aderimin në BE;
- Institucionet e Bashkimit Evropian;
- Kuadrin legjislativ dhe rregullator mbi IPA II (<https://dap.gov.al/legjislacioni/ligje/ligj-nr-372015/>; <https://dap.gov.al/legjislacioni/vendime/vendim-nr-541-date-1862015/>);
- Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- Legjislacionin mbi auditimin;
- Legjislacionin tatimor;
- Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe aktet normative në zbatim të tij);
- Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Legjislacionin e prokurimit publik;
- Legjislacionin për menaxhimin financiar;
- Legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor (ligji nr. 9936, datë 26/06/2008, i ndryshuar);
- Legjislacionin për rregullat e etikës në administratën publike (ligji nr. 9131, datë 08/09/2003).

B. Aftësitë për të:

- Drejtuar dhe menaxhuar skuadrën;
- Organizuar dhe ndarë punën në institucionin që drejton;
- Menaxhuar situata emergjente;
- Menaxhuar situata të cilat nuk kanë qenë të parashikuara;
- Marrë vendime mbi bazën e argumentave;
- Shprehur opinionin dhe argumentat në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme;
- Respektuar të tjerët (kolegët, vartësit, qytetarët) dhe dëgjuar opinionin e tyre;
- Bashkëpunuar me kolegët, duke ndarë me ta informacionin dhe njohuritë e nevojshme;
- Komunikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumenta dhe analizë të pasojave;
- Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionit me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimin e rrugëve dhe hartimin e planeve për mënjanimin e risqeve në realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore dhe materiale me kosto sa më të ulët dhe me rendiment maksimal;
- Krijuar procedura apo politika të reja;
- Ndryshuar procedura apo politika ekzistuese në mënyre inovative;
- Menaxhuar dhe inkurajuar skuadrën për të zhvilluar ide të reja.

V.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Konkurrimi i kandidatëve pjesëmarrës konsiston në:

- 1.- Vlerësimin e jetëshkrimit, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 10 pikë.
- 2.- Testimin me shkrim. Totali i pikëve është 40 pikë.
- 3.- Intervistën e strukturuar me gojë. Totali i pikëve është 50 pikë.

Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën sipas përcaktimit në pikën IV të kësaj shpalljeje.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 6, datë 19.09.2014, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al, i ndryshuar.

<https://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime/udhezim-nr6-date-19092014/>

VI.- Data e zhvillimit të konkurrimit

Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **27 Mars 2026**. Lidhur me orën dhe vendin e zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga DAP.

Pas zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët do të njoftohen nëpërmjet adresës së tyre elektronike, në lidhje me datën dhe orën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

VII.- Data e shpalljes së rezultateve

Lista e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë do të shpallet në faqen e internetit www.dap.gov.al, ambientet e Departamentit të Administratës Publike dhe në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në datën **6 Prill 2026**.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk janë shpallur fitues do të njoftohen nga DAP nëpërmjet adresës së tyre të e-mail.